

VENDIM
Nr. 703, datë 9.9.2020

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, TË PRONËS SHETETËRORE ME
NOMENKLATURË K-34-112-127-D, ME NUMËR PASURIE 402, 403, 404, 405, 406, 410
(NUMËR 19 SIPAS HARTËS SË KADASTRËS DAMT), 411 (NUMËR 20 SIPAS
HARTËS SË KADASTRËS DAMT), 412, 413 e 414, ZONA KADASTRALE NR. 2443,
BASHKIA FIER, NJËSIA ADMINISTRATIVE LIBOFSHË, DHE TË PRONËS
SHETETËRORE SIPAS HARTËS TREGUESE, ME NOMENKLATURË K-34-111-(111-
D), ME NUMËR PASURIE 218/6, 220/1, 220/3, 221/1, 221/3, 224/1, 225/1, 226/1,
227/3, 228/1, 228/3, 229/3, 230/1, 231/1 e 232/1, ZONA KADASTRALE NR. 2085,
KARAVASTA E RE, NJËSIA ADMINISTRATIVE REMAS, BASHKIA DIVJAKË**
(ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1026, datë 16.12.2020)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të pronës shtetërore, me nomenklaturë k-34-112-127-d, me numër pasurie 402, 403, 404, 405, 406, 410 (numër 19 sipas hartës së kadastrës DAMT), 411 (numër 20 sipas hartës së kadastrës DAMT), 412, 413 e 414, zona kadastrale nr. 2443, Bashkia Fier, Njësia Administrative Libofshë, dhe të pronës shtetërore me nomenklaturë k-34-111-(111-d), me numër pasurie 218/6, 220/1, 220/3, 221/1, 221/3, 224/1, 225/1, 226/1, 227/3, 228/1, 228/3, 229/3, 230/1, 231/1 e 232/1, zona kadastrale nr. 2085, Karavasta e Re, Njësia Administrative Remas, Bashkia Divjakë, me vendndodhje dhe sipërfaqe sipas anekseve 1 e 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Pronat e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, do të përdoren për zhvillimin e projektit për ndërtimin e impiantit fotovoltai, në zonën e Remas, Divjakë – Karavasta, Lushnjë.

3. Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë i lejohej vënia në dispozicion e pronave të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, shoqërisë së shpallur fituese nga procesi konkurrues i zhvilluar nga ministria, për të gjithë kohëzgjatjen e tij, në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar.

4. Vendimi nr. 727, datë 8.12.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e pronës shtetërore sipas hartës treguese, me nomenklaturë k-34-112-127-d, me numër pasurie 402, 403, 404, 405, 406, 410 (numër 19 sipas hartës së kadastrës DAMT), 411 (numër 20 sipas hartës së kadastrës DAMT), 412, 413 e 414, zona kadastrale nr. 2443, Bashkia Fier, Njësia Administrative Libofshë, dhe të pronës shtetërore sipas hartës treguese, me nomenklaturë k-34-111-(111-d), me numër pasurie 220/1, 220/3, 221/1, 221/3, 224/1, 225/1, 226/1, 227/1, 227/3, 228/1, 228/3, 229/1, 229/3, 230/1, 231/1 e 232/1, zona kadastrale nr. 2085, Karavasta e Re, Njësia Administrative Remas, Bashkia Divjakë, në fondin e pasurive të paluajtshme, për mbështetjen e investimeve strategjike dhe vënien në dispozicion të pasurisë së paluajtshme shtetërore për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik ‘Albpanel’”, shfuqizohet.

5. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

ANEKS I
ZONA KADASTRALE NR. 2443, BASHKIA FIER, NJËSIA ADMINISTRATIVE
LIBOFSHË

Nr. rendor Njësia administrative Zona kadastrale Numri i parcelës Sipërfaqe në m²

1. Libofshë 2443 402 96400
2. 403 98200
3. 404 92200
4. 405 96900
5. 406 97700
6. 410
(nr. 19 sipas hartës së kadastrës DAMT) Nevojitet regjistrim fillestar
7. 411
(nr. 20 sipas hartës së kadastrës Nevojitet regjistrim fillestar DAMT)
8. 412 90800
9. 413 98300
10. 414 98300

ANEKS II
ZONA KADASTRALE NR. 2085, KARAVASTA E RE, NJËSIA ADMINISTRATIVE
REMAS

(ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1026, datë 16.12.2020)

Nr. rendor, Njësia administrative, Zona kadastrale, Numri i parcelës, Sipërfaqe në m²

1. Remas 2085 218/6 13125
2. 220/1 33774
3. 220/3 64593
4. 221/1 18548
5. 221/3 148757
6. 224/1 166155
7. 225/1 149506
8. 226/1 144257
9. 227/3 64766
11. 228/1 16256
12. 228/3 90262
13. 229/3 98642
15. 230/1 81900
16. 231/1 72360
17. 232/1 34410